



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.81/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me apelin e Meriton Mihovci nga Zvicra, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 23.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet si i pasafatshëm** apeli i identifikuar me numrin Anr.81/2019 i datës 22.09.2019, i parashtruar nga Meriton Mihovci nga Zvicra me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

## A r s y e t i m

Me datën 22.09.2019, PZAP-i ka pranuar apel nga Meriton Mihovci, në të cilën parashtruesi pretendon se ai ka aplikuar për votim jashtë Kosovës, por në listat përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja parashtruesi nuk figuron në listë, KQZ-ja me email ka njoftuar se nuk i plotëson kushtet për tu përfshirë në listë, dhe parashtruesi me anë të këtij apeli dëshiron të di arsyen e refuzimit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi afatshmërinë e apelit, në kuptim të nenit 11 par.5 të Rregullores Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat, gjeti se:

### **Apeli është i pasafatshëm**

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga Meriton Mihovci, kundër KQZ-së, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 122 par.1 të LZP-së, ku përcaktohet: “*Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda (24) orëve*”. Ngase prej shkresave të lëndës del se perioda e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, është realizuar nga data 30.08.2019 dhe ka përfunduar me datën 10.09.2019. Vendimi i KQZ-së për Certifikimin e Listës së Votuesve jashtë Kosovës, është publikuar me datën 19.09.2019, ndërsa afati për ankesa ka qenë 24 (njëzetekatër) orë nga marrja e vendimit. Apeli në PZAP nga Meriton Mihovci, është paraqitur me datë 22.09.2019, çka do të thotë se apeli është parashtruar pas afatit të përcaktuar në dispozitën Ligjore të nenit 122 par.1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115.1 dhe nenit 118 të LZP-së dhe 11 par 5 të Rregullores Nr. 02/2015 për Rregullat dhe Procedurat paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A.nr. 81/2019 me datën 23.09.2019

**Kryesues i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**



*Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*